



**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
*Departamenti i Auditimit të Administrimit të Aseteve,*  
*Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit*

---

Nr. 961/5 Prot.

Tiranë, më 24.12.2016

**V E N D I M**

**Nr.156, Datë 24.12.2016**

**PËR**  
**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË**  
**INSPEKTORATIN SHTETËROR TË MJEDISIT DHE TË PYJEVE QARKUT**  
**SHKODËR "MBI ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË, RREGULLSHMËRISË,**  
**ADMINISTRIMIT FINANCIAR DHE VLERËSUES ”.**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projekt vendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Administrimit të Aseteve, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Sigurimit të Standardeve dhe Etikës, mendimin e Drejtorit të Përgjithshëm, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të Administrimit të Aseteve, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, në mbështetje të neneve 10, 15 dhe 30, të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

**V E N D O S A:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë, për procedurën e pranimit dhe administrimit të dokumentacionit për vlerësimin dhe evidentimin e trajtimit ligjor të tyre”, të ushtruar në ISHM Shkodër për periudhën 01.01.2014 deri më 30.06.2016.

**II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

## A. MASA ORGANIZATIVE

**1-** Në **143 raste**, inspektorët e mjedisit gjatë kryerjes së inspektimeve në fushën e mjedisit, megjithëse kanë konstatuar shkelje të dispozitave ligjore nga subjekte të ndryshme, lidhur me mos pajisjen me Leje Mjedisore, ose mos zbatim të kushteve të lejes, për të cilat ka lënë afate kohore për korrigjimin e parregullive, por subjektet nuk kanë konfirmuar përmbushjen e detyrimeve ligjore, ndërsa inspektorët e mjedisit nuk kanë zbatuar masa administrative dënimi me gjobë për subjektet kundërvajtës, duke krijuar **të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit në vlerën totale 43,420,000 lekë**, nga të cilat 26 raste për vitin 2014 dhe 6 mujorin e parë të vitit 2016 në vlerë 7,800,000 lekë dhe 117 raste për vitin 2015, në vlerën 35,620,000 lekë, veprime këto në mospërputhje me pikën 1/iii, neni 29, të Ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar dhe pikën 5, pikën 6, neni 48, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, (trajtuar në faqen 13-40 të këtij Raportit Përfundimtar të Auditimi).

**Për këtë rekomandojmë:** DR ISHMP Shkodër të marrë masa për të monitoruar dhe programuar kontrolle më të shpeshta të subjekteve, që përmbajnë risk më të lartë lidhur me shkeljet në fushën e mjedisit, si dhe të rikontrollohen të gjithë subjektet që janë klasifikuar me shkelje të dispozitave ligjore, duke përcaktuar nëse është bërë korrigjimi i parregullive të konstatuara dhe në çdo rast të konstatimit të mos përmbushjes së detyrimeve ligjore, të zbatohet masa administrative dënim me gjobë për subjektet kundërvajtëse, konform përcaktimeve ligjore (sipas pasqyrës nr. 2, bashkëlidhur).

**Menjëherë**

**2-Gjetje nga auditimi ;** DR ISHMP Shkodër, në **53 raste** dënimesh administrative/gjoha, me vlerë të përgjithshme 5,990,000 lekë, nga të cilat 25 raste me vlerë 3,650,000 lekë për vitin 2014, dhe 25 raste në vlerë 2,340,000 lekë me për vitin 2015, të pa ankimuara brenda afateve që parashikon ligji i posaçëm, nuk ka respektuar afatet që pas kalimit të afatit 30 ditor të bëhej kërkesa drejtuar gjykatës për nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit dhe më pas ndjekjen nga shërbimi përmbarimor, veprime këto në papajtueshmëri me pikën 1 neni 22, pika 4 shkronja b e nenit 30 të Ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative” (trajtuar në faqen 13-40 të këtij Raportit Përfundimtar të Auditimi).

**Për këtë rekomandojmë:** ISHMP Shkodër, Sektori Inspektimit të Pyjeve, Juristi për dënimet administrative me gjobë, të cilat nuk janë ankimuara nga subjektet brenda afatit 30 ditor, të marrin masa të hartojnë program të posaçëm për zbatimin e procedurave ligjore të ekzekutimit dhe arkëtimit të gjobave të vendosura, t’i drejtohet gjykatës për nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit dhe më pas ndjekjen nga shërbimi përmbarimor.

**Në vijimësi**

**3.Gjetje nga auditimi:** Në Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit të Qarkut Shkodër nuk janë pasqyruar si dhe nuk janë kontabilizuar gjobat e vendosura për kundërvajtjet administrative në pasqyrën ekstra kontabël në bilanc, për **86 raste në vlerën totale prej 63,830 mijë lekë**, të ndarë sipas viteve, për vitin 2014 janë 38 **raste në vlerën totale prej 11,650 mijë lekë**, për vitin 2015 janë 40 **raste në vlerën totale prej 7,180 mijë lekë** dhe për vitin 2016 janë 8 **raste në vlerën totale prej 45,000 mijë lekë**, në kundërshtim me ligjin 9228 dt. 29.04.2004 Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” i ndryshuar, nenet 3 pika 1, neni 6 pikat 1,2, ndërsa moskryerja e veprimeve procedurale për arkëtimin e gjobave, në kundërshtim me nenet 9,27,43, pika 1. të Ligjit Nr. 10279 dt. 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative” (trajtuar në faqen 48-50 të këtij Raportit Përfundimtar të Auditimi).

**Për këtë rekomandojmë:** Inspektoratin Shtetëror i Mjedisit të Qarkut Shkodër të marrë masa për arkëtimin e gjobave të vendosura për kundërvajtjet administrative dhe të kontabilizojë këto gjoba në bilancin e vitit ushtrimor, sipas procedurave ligjore.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi.*

**4-Gjetje nga auditimi:** Inspektorët e DR ISHMP Shkodër në 16 raste, nga të cilat **5 raste për sasinë 267 m<sup>3</sup> lëndë drusore** dhe **11 raste për sasinë 123.3 m<sup>3</sup> lëndë përpunuese** trup pishe, **218 mst lëndë dru zjarri** të llojit ah dhe lis **dhe 10.4 m<sup>3</sup> lëndë dru zjarri**, kanë konstatuar prerje të paligjshme të pyjeve për përdorim si lëndë përpunuese dhe si lëndë dru zjarri, por **mungon dokumentacioni përkatës** që vërteton marrjen e masave për bllokimin, sekuestrimin dhe dorëzimin e materialit në pikat e licencuara të grumbullimit, për rrjedhojë kjo sasi lëndë drusore rezulton e pa dorëzuar në pikat e grumbullimit, veprime këto në papajtueshmëri me nenin 39 të ligjit nr. 9385 datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” neni 11, pika 1 të Ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative” (*trajtuar në faqen 13-40 të këtij Raportit Përfundimtar të Auditimi*).

**Për këtë rekomandojmë:** DR ISHMP Shkodër në bashkëpunim me strukturat e mbrojtjes së pyjeve në pushtetin vendor, të marrë masa që në vazhdimësi për të gjitha rastet e konstatimit të prerjes së lëndës drusore në mënyrë të pa ligjshme, me ose pa autor, të bëjë dorëzimin e materialit drusor në pikat e grumbullimit, duke e dokumentuar me procesverbal dorëzimi të nënshkruar.

*Në vijimësi*

**5-Gjetje nga auditimi:** Në 8 raste nga ana e inspektorëve të ISHMP Shkodër, në vendimet e marra për kundërvajtjet administrative, sekuestrim të lëndës drusore të transportuara me mjet transporti, ka sekuestruar vetëm materialin drusor, nuk kanë zbatuar procedurat ligjore të sekuestrimit të mjetit, në kundërshtim me nenin 11 (Pika 1) të ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Sekuestrimi dhe konfiskimi i sendeve”, si dhe nenin 39 “Sekuestrimet të ligjit Nr. 9385, date 04.05.2005 të ndryshuar (*trajtuar në faqen 13-40 të këtij Raportit Përfundimtar të Auditimi*).

**Për këtë rekomandojmë:** DR ISHMP Shkodër për rastet kur ligji i posaçëm parashikon për kundërvajtjet administrative edhe sekuestrimin apo konfiskimin e mjeteve, automjetet që kanë shërbyer ose që ishin caktuar për të shërbyer si mjete për kryerjen e kundërvajtjes administrative, të sekuestrohen dhe të kalojnë për ruajtje në pikën përkatëse të bllokimit.

*Në vijimësi*

**6-Gjetje nga auditimi:** Punonjësve të ISHMP Shkodër, **nuk ju janë mbajtur sigurimet shtetërore suplementare** në kundërshtim me ligjin nr. 8097, datë 21.03.1996 "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", i ndryshuar me ligjin nr. 9990 date 15.09.2008, neni 1 pika 9, si dhe referuar kërkesave të. Vendimit nr 499, date 21.09.2000 pika 3 dhe 4 (*trajtuar në faqen 40-44 të këtij Raportit Përfundimtar të Auditimi*).

**Për këtë rekomandojmë:** Nga ISHMP Shkodër t'i kërkohej zyrtarisht Inspektoratit Qendror, që në mbështetje të akteve ligjore në fuqi cituar sa më sipër, të ndërmarrë hapat përkatëse për përfshirjen e punonjësve të institucionit në listën e punonjësve me detyrimin konform ligjit, të pagesave të sigurimeve suplementare.

*Menjëherë*

**7-Gjetje nga auditimi:** Nga ana e DR ISHMP Shkodër, nuk është kryer inventarizimi i dosjeve të personelit sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 117, datë 05.03.2014, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të

personelit” sipas lidhjes 1 dhe lidhjes 2 (trajtuar në faqen 40-44 të këtij Raportit Përfundimtar të Auditimi).

**Për këtë rekomandojmë:** Nga sektori përkatës që mbulon burimet njerëzore në DR të ISHMP Shkodër të merren masa për plotësimin e dosjeve të personelit me të gjitha të dhënat konform kërkesave ligjore dhe çdo dosje duhet të ketë inventarin e dosjes të konfirmuar nga palët

*Menjëherë*

**8- Gjetje nga auditimi:** Nga DR ISHMP pasqyrat e plotësuara për treguesit financiarë *nuk janë shoqëruar me objektivat që ka institucioni për vitin 2015, të cilat do të jenë produktet dhe aktivitetet që do të realizohen me fondet e kërkuara*, veprim në kundërshtim me standardet e parashikuara në udhëzimet e hartimit të buxhetit për vitin 2015 në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 7 datë 28.02.2014 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2015-2017” si dhe udhëzimin plotësues (trajtuar në faqen 11-13 të këtij Raportit Përfundimtar të Auditimi).

**Për këtë rekomandojmë:** Nëpunësi zbatues i DR ISHMP Shkodër, pasqyrat e plotësuara për treguesit financiar, t’i shoqërojë me objektivat që ka institucioni për çdo vit ushtrimor, të cilat do të jenë produktet dhe aktivitetet që do të realizohen me fondet e kërkuara.

*Menjëherë*

**9- Gjetje nga auditimi** Nga ana e ISHMP –së, nuk është ngritur që në fillim të vitit kalendarik komisioni i blerjeve me vlerë të vogla ku përcaktohet se “Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizua prej tij në fillim të çdo viti kalendarik ngre komisionin e prokurimit me vlerë të vogël”, veprime që bien në kundërshtim me udhëzimin nr. 3 datë 27.0.2015 “Për blerjet me vlera të vogla” pika 2 (trajtuar në faqen 50-51 të këtij Raportit Përfundimtar të Auditimi).

**Për këtë rekomandojmë:** Titullari i DR të ISHMP Shkodër të marrë masa për ngritjen e komisionit të blerjeve me vlera të vogla që në fillim të vitit kalendarik, sipas udhëzimit të sipërcituar.

*Menjëherë*

**10- Gjetje nga auditimi** Në të gjitha raste e blerjeve të vogla nuk është ngritur urdhër nga AK për përllogaritjen e fondit limit të blerjeve të vogla, veprime të cilat bien në kundërshtim me nenin 5 të VKM nr. 914 datë 29.12.201, “Për rregullat e prokurimit Publik”, si dhe Udhëzimit nr. 57 datë 12.06.2014, “Gjurma Standarde e Auditimit” në rast se NJP nuk ka specialist të fushës specifike të objektit të prokurimit, përgatitet urdhri i ngritjes së grupit të punës për përllogaritja e fondit limit nga NJP dhe miratimi nga titullari i AK ose PA prej tij (trajtuar në faqen 50-51 të këtij Raportit Përfundimtar të Auditimi).

**Për këtë rekomandojmë:** Titullari i DR të ISHMP Shkodër të marrë masa për ngritjen e komisionit për përllogaritjen e fondit limit, që në çdo procedurë prokurimi me vlera të vogla, fondi limit të llogaritet dhe të dokumentohet me procesverbal përkatës.

*Menjëherë*

**11- Gjetje nga auditimi** Në disa raste procedura e blerjeve me vlera të vogla nuk kanë filluar me kërkesë të sektorëve përkatës të cilat kanë nevojë për mallra, shërbime dhe punë. Në të shumtat e rasteve procedurat e blerjeve kanë filluar me urdhrat e prokurimit të nxjerrë nga Titullari i autoritetit kontraktor, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015, “Për prokurimet me vlera të vogël” pika 4, si dhe Urdhrin nr. 57 datë 12.06.2014, Gjurma Standarde e Auditimit për Prokurimin me vlerë me të madhe se 400 mijë lekë, pa tvsh dhe me vlerë me të vogël se 400 mijë lekë me tvsh (trajtuar në faqen 50-51 të këtij Raportit Përfundimtar të Auditimi).

**Për këtë rekomandojmë:** Në çdo rast procedurat me vlera të vogla, të fillojnë në bazë të kërkesave të sektorëve përkatës të cilat kanë nevojë për mallra, shërbime dhe punë.

**Vazhdimisht**

**12- Gjetje nga auditimi** Nga N/A nuk janë ngritur komisione të pritjes së mallit ose marrjen në dorëzim që në fillim të vitit kalendarik veprime të cilat bien në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e sektorit Publik” kapitulli III, marrja në dorëzim e aktiveve, pika 42. Të gjitha këto veprime bien në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”. Kreu III pika 34 nënpika a, dokumentuat autorizuese dhe nënpika b, dokumentet vërtetueses si dhe pikat 52,53,54 për veprimet që kryen nëpunësi zbatues (*trajtuar në faqen 50-51 të këtij Raportit Përfundimtar të Auditimi*).

**Për këtë rekomandojmë:** Në çdo fillim viti të ngrihen komisionet e marrjes në dorëzim të mallrave, shërbimeve dhe punëve. Në çdo urdhër-shpenzimi (pagesë) të lidhet dokumentacioni justifikues dhe plotësues që vërteton kryerjen e pagesës.

**Menjëherë**

**13- Gjetje nga auditimi** Komisioni i vlerësimit të blerjeve me vlera të vogla, nuk ka bërë inventarizimin dhe arkivimin e dokumentacionit të dosjeve të, procedurave zbatuar për blerjet me vlera të vogla mosveprime të cilat bien në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 datë 03.04.2014 “Për një shtesë në udhëzimin nr. 4, datë 04.07.2013, të Agjencisë së Prokurimit Publik, “Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë” ku thuhet shprehimisht që “autoriteti kontraktor duhet të bëjë arkivimin e procedurës së prokurimit brenda 1 ditë punë nga mbyllja e fazës së njoftimit fitues (*trajtuar në faqen 50-51 të këtij Raportit Përfundimtar të Auditimi*).

**Për këtë rekomandojmë:** Komisioni i vlerësimit të ofertave për çdo rast për blerjet me vlerë të vogël të kryejë inventarizimin dhe arkivimin e dokumentacionit të praktikave sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 3 datë 03.04.2014 “Për një shtesë në udhëzimin nr. 4, datë 04.07.2013.

**Vazhdimisht**

**14- Gjetje nga auditimi:** Specialisti i financës së ISHMP-së Shkodër, nuk ka kryer kontabilizimin e veprimeve, në kundërshtim me *ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004, “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrave Financiare”*. Gjithashtu në kundërshtim të VKM-së nr. 783, datë 22/11/2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”, *regjistrimet kontabël kryhen në kohën e lindjes së një të drejte për të arkëtuar ose të një detyrimi për t’u paguar nga njësia ekonomike, të drejta dhe detyrime këto që sjellin në të ardhmen arkëtime ose pagesa, por që kanë sjellë për ushtrimin e dhënë të ardhura ose shpenzime”* (*trajtuar në faqen 48-50 të këtij Raportit Përfundimtar të Auditimi*).

**Për këtë rekomandojmë :** Specialisti i financës së DR ISHMP-së Shkodër, të marrë të gjitha masat për instalimin e evidencës kontabile, për të çelur ditarët kontabël dhe pasqyruar veprimet ekonomike sistematikisht dhe në kronologji. Gjithashtu në bilancin e veprimtarisë së vitit 2016, të shkarkohen nga kartelat dhe të hiqen nga vlerat e bilancit vlera prej 433,645 lekë dhe me veprim të veçantë të sistemohet nëpërmjet ditarit të veprimeve të ndryshme. Mbajtja e kontabilitetit të bëhet në mënyrë të informatizuar nëpërmjet programeve informatike përkatëse.

**Menjëherë**

**15- Gjetje nga auditimi:** Nga evidenca e grumbulluar dhe raportimet e subjektit rezulton se DR ISHMP Shkodër, nuk ka hartuar strategji afatmesme apo vjetore, ku të përcaktohen objektivat sipas prioriteteve që duhet të arrijë, për plotësimin e misionit të ngarkuar nga kuadri rregullator në fuqi dhe veprimtarinë e saj e ka kryer duke u mbështetur në plane pune mujore me mundësi rastësore të planifikimit të inspektimeve, pa u mbështetur në një analizë të mirëfilltë e reale të mundësive, analizë të faktorëve që suportojnë dhe atyre që bëhen pengesë, në madhësinë së territorit dhe veçorive të zonës referuar karakteristikave të mjedisit dhe pyjeve, në mundësinë e bashkëpunimit me aktorë të tjerë. Gjithashtu në institucion nuk ka një strategji të miratuar të riskut, nuk janë përcaktuar procedura të menaxhimit të riskut dhe nuk ekziston regjistri i identifikimit të risqeve dhe menaxhimit të tyre; gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin *(trajtuar në faqen 52-55 të këtij Raportit Përfundimtar të Auditimi)*).

**Për këtë rekomandojmë:** Kryeinspektori i DR ISHMP Shkodër, në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues dhe Përgjegjës të Sektorëve, në bazë të analizës së punës së institucionit dhe të rezultateve të saj, të hartojë strategjinë afatmesme dhe vjetore për vitin 2017, duke përcaktuar objektiva konkret dhe të matshëm të veprimtarisë së institucionit. Në këtë kuadër të vlerësohen ngjarjet apo fushat që parashikohen me risk për arritjen e objektivave, të renditen në një strategji të identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të riskut si dhe të caktohet koordinatori i riskut për ndjekjen e procesit në vazhdimësi, sipas përcaktimeve të MFK. Ndër objektivat kryesore të vlerësohet mundësia e përfshirjes së përgatitjes së rregullores së brendshme të institucionit, duke reflektuar në të kërkesat specifike të ligjit për MFK dhe akteve të tjera në fuqi.

***Menjëherë***

**16- Gjetje nga auditimi** . ISHMP Shkodër, për periudhën e audituar nuk ka miratuar rregulla të brendshme, për procedurat standarde të përdorimit të fondeve buxhetore për shpenzimet për paga, shpenzimet operative sipas llojit, për administrimin e aseteve dhe materialeve të institucionit, si dhe të rregullave të procedurave të prokurimit publik, me synim garantimin e sigurisë së të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që tu mundësojë audituesve të brendshëm e të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse, kuptimin dhe vlerësimin e mjedisit të kontrollit, veprim në kundërshtim me nenin 9, pika 2 dhe nenin 16, pika 2, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin *(trajtuar në faqen 52-55 të këtij Raportit Përfundimtar të Auditimi)*).

**Për këtë rekomandojmë:** Kryeinspektori i DR ISHMP Shkodër, në cilësinë e Titullarit të institucionit dhe të Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për instalimin dhe vendosjen e sistemit të mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe të hartohen e miratohen rregullat për procedurat standarde të shpenzimeve, sipas udhëzimeve të nxjerra nga Ministria e Financave në zbatim të Ligjit.

***Menjëherë***

### **17- Gjetje nga auditimi**

DR ISHMP Shkodër, nuk ka regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme për objektin “Ndërtesë” pronë e patundshme e këtij institucioni, siç përcaktohet në kërkesat e VKM nr. 620, datë 15.09.2006 dhe nenin 11 të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” *(trajtuar në faqen 44-48 të këtij Raportit Përfundimtar të Auditimi)*.

**Për këtë rekomandojmë:** Nga ana e DR ISHMP Shkodër të merren masat që Sektori i Shërbimeve të Brendshme, (zyra teknike) të fillojë menjëherë procedurat përkatëse të regjistrimit të pasurisë në ZVRPP Shkodër.

***Menjëherë***

**18. Gjetje nga auditimi:** DR ISHMP Shkodër, nuk ka një Rregullore të Brendshme të hartuar dhe miratuar në zbatim të VKM nr. 47, datë 29.01.2014 i cili përcakton se veprimtaria e ISHM detyrat sipas sektorëve përkatës deri tek inspektori sipas ligjit. Në këtë institucion nuk janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet që ngarkon ligji për plotësimin e misionit dhe veprimtarisë së tyre. Veprimtaria e miratimit apo autorizimeve, inspektimeve, kontabilizimeve, protokollimit e dokumentacionit, hyrjeve e daljeve nga magazinat me formularë përkatës, bëhet formale dhe pa u shprehur për përmbajtjen profesionale të aktivitetit (*trajtuar në faqen 13-40 të këtij Raportit Përfundimtar të Auditimi*).

**Për këtë rekomandojmë:** Titullari i ISHM Shkodër mbi bazën e VKM së krijimit dhe dispozitave ligjore të hartojë Rregulloren e Brendshme dhe t'i kërkojë Ministrisë së Mjedisit, si organ i vartësisë, miratimin e kësaj Rregulloreje.

*Menjëherë*

**19- Gjetje nga auditimi:** Gjatë konstatimit të dëmtimit të ekonomisë pyjore, nga persona të identifikuar, megjithëse janë marrë masa penalizuese me gjobë, inspektorët e policisë pyjore nuk kanë bërë vlerësimin e dëmit të shkaktuar nga kundërvajtësit për të bërë të mundur, zhdëmtimin e këtij dëmi nga personat përgjegjës, veprim në papajtueshmëri me pikën 1, neni 40/1, të ligjit nr. 9385, datë 4.0.2005 “Për Pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar (*trajtuar në faqen 13-40 të këtij Raportit Përfundimtar të Auditimi*).

**Për këtë rekomandojmë:** DR ISHMP Shkodër të marrë masa në vazhdimësi, për të gjitha rastet që inspektorët konstatojnë prerje të paligjshme të lëndës drusore, krahas dënimit kryesor administrativ, duhet të bëjnë vlerësimin e dëmit të shkaktuar, për të bërë të mundur, zhdëmtimin e këtij dëmi nga personat kundërvajtës.

*Në vijimësi*

**20- Gjetje nga auditimi:** Nuk ka një bashkëpunim efektiv ndërmjet sektorëve të inspektimit të policisë pyjore të ISHMP Shkodër, me strukturat e tjera policore e shtetërore dhe drejtoritë përkatëse të menaxhimit të pyjeve të pushtetit vendor, lidhur me shkëmbimin e informacionit, për të bërë të mundur parandalimin e kundërvajtjeve, si dhe zbulimin e rasteve të konstatuara pa autor, për dëmet e shkaktuara në ekonominë pyjore, veprim në mos përputhje me pikën 4, neni 37, të ligjit nr. 9385, datë 4.0.2005 “Për Pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar (*trajtuar në faqen 13-40 të këtij Raportit Përfundimtar të Auditimi*).

**Për këtë rekomandojmë:** DR ISHMP Shkodër të marrë masa në vazhdimësi, që të krijojë një bashkëpunim të vazhdueshëm me strukturat e tjera policore e shtetërore dhe drejtoritë përkatëse të menaxhimit të pyjeve të pushtetit vendor, duke shkëmbyer informacione dhe duke kryer veprime të përbashkëta, për të bërë të mundur parandalimin e kundërvajtjeve, si dhe zbulimin e rasteve të konstatuara pa autor.

*Menjëherë*

**21- Gjetje nga auditimi:** Inspektorët e policisë Pyjore të DR ISHMP Shkodër, gjatë ushtrimit të detyrave, nuk janë të pajisur me uniformë dhe shenja dalluese, si dhe me mjete teknike të nevojshme, siç përcaktohet në pikën 5, të VKM nr. 103, datë 4.02.2015 (*trajtuar në faqen 13-40 të këtij Raportit Përfundimtar të Auditimi*).

**Për këtë rekomandojmë:** DR ISHMP Shkodër të marrë dhe të kërkojë mbështetje nga strukturat e larta të varësisë, për të bërë të mundur kompletimin e Inspektorëve të policisë pyjore me uniforma dhe shenjat përkatëse dalluese, si dhe me mjete teknike të nevojshme, për të patur një rritje të performancës dhe rezultateve të punës.

*Në vijimësi*

**22-Gjetje nga auditimi:** Nga inspektimet e kryera në spitalet dhe qendrat shëndetësore në Qarkun Shkodër, si subjekte kryesore të prodhimit të mbetjeve spitalore, rezultojnë të *pa pajisur me leje mjedisore*, veprim në kundërshtim me pikën 3, neni 23, të ligjit nr. 10463, datë 22.0.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të mbetjeve” dhe me pikën 10.1, kreu IV, VKM nr. 798, datë 29.09.2010, (*trajtuar në faqen 13-40 të këtij Raportit Përfundimtar të Auditimi*).

**Për këtë rekomandojmë:** DR ISHMP Shkodër të marrë masa për të monitoruar dhe programuar kontrolle të vazhdueshme të subjekteve që prodhojnë mbetjeve spitalore, për të bërë mundur detyrimin e tyre për tu pajisur me leje mjedisore, në përmbushje të detyrimeve ligjore.

***Brenda datës 31.01.2017***

**23-Gjetje nga auditimi:** Subjektet prodhuese të mbetjeve spitalore, nuk kanë *hartuar një rregullore të brendshme për administrimin e mbetjeve spitalore dhe asndonjë plan për administrimin e mbetjeve spitalore*, si dhe *nuk bëhet monitorimi lidhur me administrimin e mbetjeve spitalore*, për ti dërguar të dhënat përkatëse çdo tre muaj në ISHMP Shkodër duke krijuar regjistrat përkatës, veprim në mos përputhje me pikat 7.1 dhe 7.2, kreu II, pikën 11.3, kreu V, të VKM nr. 798, datë 29.09.2010 (*trajtuar në faqen 13-40 të këtij Raportit Përfundimtar të Auditimi*).

**Për këtë rekomandojmë:** DR ISHMP Shkodër të marrë masa për të monitoruar, duke ushtruar kontrolle të vazhdueshme në subjektet që prodhojnë mbetjeve spitalore, për të bërë mundur detyrimin e tyre për të hartuar rregullore të brendshme dhe një plan lidhur me administrimin e mbetjeve spitalore, si dhe të bëhet monitorimi i tyre, duke hedhur të dhënat në regjistra përkatës.

***Brenda datës 31.01.2017***

**24- Gjetje nga auditimi:** ISHMP *Shkodër* gjatë ushtrimit të detyrave, lidhur me menaxhimin e mbetjeve urbane nga njësitë e pushtetit vendor, nuk ka pasqyruar dhe përcaktuar, nëse këto subjekte kanë *hartuar plane vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve*, brenda juridiksionit të secilës bashki, si dhe *nuk është pasqyruar lidhja e kontratave* me subjektet e licencuara II/2.B “Për transport të mbetjeve urbane” dhe për vend depozitimin e mbetjeve urbane, sipas kërkesave të pikës 2, neni 12, pikës , të nenit 57, të ligjit nr. 10463, datë 22.0.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të mbetjeve”, vepruar në mos përputhje me nenin 56, të ligjit nr. 10463, datë 22.0.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të mbetjeve” (*trajtuar në faqen 13-40 të këtij Raportit Përfundimtar të Auditimi*).

**Për këtë rekomandojmë:** DR ISHMP Shkodër të marrë masa për të programuar dhe ushtruar kontrolle të vazhdueshme në njësitë e pushtetit vendor të Qarkut Shkodër, lidhur me menaxhimin e mbetjeve urbane nga ana e tyre, për të bërë të mundur plotësimin e të gjitha kërkesave në fushën e mjedisit, duke ndikuar në rritjen e cilësisë së mjedisit dhe mbrojtjen e jetës së qytetarëve.

***Brenda datës 31.01.2017***

**25- Gjetje nga auditimi:** ISHMP Shkodër, gjatë ushtrimit të aktivitetit, nuk ka kryer një kontroll të vazhdueshëm dhe efektiv për mbrojtjen e mjedisit në zonat me rëndësi të veçantë, pasi nuk ka programuar inspektime më të shpeshta të zonave turistike, zonave të mbrojtura dhe zonave arkitekturore, për të bërë të mundur dhënien e përparësisë së mbrojtjes së mjedisit në këto zona (*trajtuar në faqen 13-40 të këtij Raportit Përfundimtar të Auditimi*).

**Për këtë rekomandojmë:** ISHMP Shkodër të marrë masa për të programuar kontrolle të vazhdueshme dhe të hartojë plane konkrete, duke i dhënë përparësi inspektimit në fushën e



mjedisit, në zonat turistike, zonat e mbrojtura dhe zonat arkitekturore, që ndodhen në qarkun e Shkodrës, duke ndikuar pozitivisht në rritjen e cilësisë mjedisore të këtyre resurseve turistike.

**Brenda datës 31.01.2017**

### **B . MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Mbështetur në nenet 105-109, kreu I, pjesa e VI, të ligjit nr. 8485, datë 08.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 20.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, kapitulli IV (Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative dhe të ndiqen rrugët ligjore, për kërkimin e shpërblimit të dëmit në vlerën **61,215 lekë**, si më poshtë:

**Për këtë rekomandojmë:** DR ISHMP Shkodër të marrë masa të kontabilizojë dhe të ndjekë të gjitha hapat e duhur ligjore për arkëtimin e shumës së dëmit ekonomik prej **61,215 lekë** të shkaktuar nga drejtuesi i mjetit E. V.

**Brenda datës 31.01.2017**

### **C. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “b” e “ç” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe në ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”, nenin 44 “Përgjegjësia e punonjësit të organit administrativ”, **i rekomandoj Kryeinspektorit të Inspektoratit Qendror të Mjedisit dhe Pyjeve Tiranë**, fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore, si më poshtë:

**C.1. “Vërejtje” deri në “Largim nga Shërbimi civil”, për 7 punonjës si më poshtë:**

**I. Për z. E. B. , me detyrë përgjegjës i Sektorit të Mjedisit, në ISHMP Rajoni Shkodër, për shkeljet trajtuar në procesverbalin nr. 7, nr. 8 , nr. 3 dhe në faqet 28-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, pasi:**

Në **143 raste**, që i përkasin periudhës 01.01.2014 deri 30.06.2016, gjatë ushtrimit të detyrave, janë konstatuar shkelje administrative, nga subjekte që nuk janë pajisur me leje mjedisore ose që kanë shkelur kushtet e lejes, për të cilat janë lënë afate për të korrigjuar parregullsitë e konstatuara, por pas përfundimit të afateve, **nuk kanë aplikuar dënim administrativ me gjobë në vlerën 300,000 lekë**, si dhe nuk kanë aplikuar dënim administrativ për mos zbatim në kohë të masave korrigjuese, në shumën 10,000 lekë secili dhe në vlerë totale **shuma 43,420,000 lekë**, e cila përbën të ardhur të munguar për Buxhetin e Shtetit, veprime këto në papajtueshmëri me shkronjat iii) iii) pika 1 neni 29, të Ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar dhe pikën 5, pikën 6, neni 48, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

- Nuk ka patur vijueshmëri dhe ndjekje të problemeve deri në zgjidhjen përfundimtare, për rrjedhojë rezultatet e inspektimeve në subjektet që administrojnë dhe menaxhojnë mbetje spitalore, nuk kanë patur efektivitet, pasi Spitalet dhe qendrat shëndetësore në Qarkun Shkodër nuk janë të pajisura me leje mjedisore, veprim në kundërshtim me pikën 3, neni 23, të ligjit nr. 10463, datë 22.0.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të mbetjeve” dhe me pikën 10.1, kreu IV, VKM nr. 798, datë 29.09.2010.

- Nuk ka grumbulluar të dhëna nga zotëruesit e mbetjeve spitalore përkatëse çdo tre muaj, lidhur me monitorimin për administrimin e mbetjeve spitalore, sipas përcaktimeve në pikën 11.3, kreu V, të VKM nr. 798, datë 29.09.2010.

- Nuk janë kryer inspektime lidhur me plotësimin e standardeve për transportin e mbetjeve nga subjektet e kontraktuara, sipas kërkesave në pikën 4, neni 23, neni 57, të ligjit nr. 10463, datë 22.0.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të mbetjeve” dhe të pikës 8.8/b dhe pikës 8.8/c, kreu III, të VKM nr. 798, datë 29.09.2010;

**2. Për z. N. D. , me detyrë inspektor në Sektorin e Mjedisit, në ISHMP Rajoni Shkodër, për 28 raste, që i përkasin periudhës 01.01.2015 deri 31.12.2015, për shkeljet trajtuar në procesverbalin nr. 7, nr. 3, nr. dhe në faqet 28-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, të pasqyruara si më poshtë:**

- Gjatë ushtrimit të detyrave, janë konstatuar shkelje administrative nga subjekte që nuk janë pajisur me leje mjedisore ose që kanë shkelur kushtet e lejes, për të cilat janë lënë afate për të korrigjuar parregullsitë e konstatuara, por pas përfundimit të afateve, nuk kanë aplikuar dënim administrativ me gjobë në vlerën 300,000 lekë, si dhe nuk kanë aplikuar dënim administrativ për mos zbatim në kohë të masave korrigjuese, në shumën 10,000 lekë secili dhe në vlerë totale **shuma 11,630,000 lekë**, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e shtetit. Veprime këto në papajtueshmëri me shkronjat iii) iii) pika 1 neni 29, të Ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar dhe pikën 5, pikën 6, neni 48, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

- Në **30 raste**, nuk ka ndjekur procedurat ligjore në afatet kohore në kundërshtim me neni 29 “Kundërvajtjet “ pika 5 e ligjit 10 448, datë 14.07.2011 i ndryshuar.

**3. Për z. Sh. Ç. , me detyrë inspektor në Sektorin e Mjedisit, në ISHMP Rajoni Shkodër, për 22 raste, që i përkasin periudhës 01.01.2015 deri 31.12.2015, për shkeljet trajtuar në procesverbalin nr. 7, nr. 3, nr. dhe në faqet 28-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, të pasqyruara si më poshtë:**

- Gjatë ushtrimit të detyrave, janë konstatuar shkelje administrative, nga subjekte që nuk janë pajisur me leje mjedisore ose që kanë shkelur kushtet e lejes, për të cilat janë lënë afate për të korrigjuar parregullsitë e konstatuara, por pas përfundimit të afateve, **nuk kanë aplikuar dënim administrativ me gjobë**, si dhe nuk kanë aplikuar dënim administrativ për mos zbatim në kohë të masave korrigjuese, në shumën 10,000 lekë secili dhe në vlerë totale **shuma 6,710,000 lekë**, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e shtetit. Veprime këto në papajtueshmëri me shkronjat iii) iii) pika 1 neni 29, të Ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar dhe pikën 5, pikën 6, neni 48, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

**4. Për z. V. Gj. , me detyrë inspektor në Sektorin e Mjedisit, në ISHMP Rajoni Shkodër, për 42 raste, që i përkasin periudhës 01.01.2015 deri 31.12.2015, për shkeljet trajtuar në procesverbalin nr. 7, nr. 3, nr. dhe në faqet 28-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, të pasqyruara si më poshtë:**

- Gjatë ushtrimit të detyrave, janë konstatuar shkelje administrative, nga subjekte që nuk janë pajisur me leje mjedisore ose që kanë shkelur kushtet e lejes, për të cilat janë lënë afate për të korrigjuar parregullsitë e konstatuara, por pas përfundimit të afateve, **nuk kanë aplikuar dënim administrativ me gjobë**, si dhe nuk kanë aplikuar dënim administrativ për mos zbatim në kohë të masave korrigjuese, në shumën 10,000 lekë secili dhe në vlerë totale **shuma 12,790,000 lekë**, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e shtetit. Veprime këto në papajtueshmëri me shkronjat iii) iii) pika 1 neni 29, të Ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, i

ndryshuar dhe pikën 5, pikën 6, neni 48, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

**5. Për z. N. P. , me detyrë inspektor në Sektorin e Mjedisit, në ISHMP Rajoni Shkodër për 54 raste, që i përkasin periudhës 01.01.2015 deri 31.12.2015, për shkeljet trajtuar në procesverbalin nr. 7, nr. 3, nr. dhe ne faqet 28-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, të pasqyruara si më poshtë:**

- Gjatë ushtrimit të detyrave, janë konstatuar shkelje administrative, nga subjekte që nuk janë pajisur me leje mjedisore ose që kanë shkelur kushtet e lejes, për të cilat janë lënë afate për të korrigjuar parregullsitë e konstatuara, por pas përfundimit të afateve, **nuk kanë aplikuar dënim administrativ me gjobë**, si dhe nuk kanë aplikuar dënim administrativ për mos zbatim në kohë të masave korrigjuese, në shumën 10,000 lekë secili dhe në vlerë totale **shuma 16,480,000 lekë**, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e shtetit. Veprime këto në papajtueshmëri me shkronjat iii) iii) pika 1 neni 29, të Ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar dhe pikën 5, pikën 6, neni 48, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

**6. Për z. N. H. , me detyrë inspektor në Sektorin e Mjedisit, në ISHMP Rajoni Shkodër, për 36 raste, që i përkasin periudhës 01.01.2015 deri 31.12.2015, për shkeljet trajtuar në procesverbalin nr. 7, nr. 3, nr. dhe ne faqet 28-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, të pasqyruara si më poshtë:**

- Gjatë ushtrimit të detyrave, janë konstatuar shkelje administrative, nga subjekte që nuk janë pajisur me leje mjedisore ose që kanë shkelur kushtet e lejes, për të cilat janë lënë afate për të korrigjuar parregullsitë e konstatuara, por pas përfundimit të afateve, **nuk kanë aplikuar dënim administrativ me gjobë**, si dhe nuk kanë aplikuar dënim administrativ për mos zbatim në kohë të masave korrigjuese, në shumën 10,000 lekë secili dhe në vlerë totale **shuma 10,940,000 lekë**, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e shtetit. Veprime këto në papajtueshmëri me shkronjat iii) iii) pika 1 neni 29, të Ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar dhe pikën 5, pikën 6, neni 48, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

- Në 4 **raste**, nuk ka ndjekur procedurat ligjore ne afatet kohore ne kundërshtim me neni 29 “Kundravajtjet” pika 5 e ligjit 10 448, datë 14.07.2011 i ndryshuar.

**7. z. A. L. ,me detyrë specialist i financës.**

- Pasi punonjësve të ISHMP Shkodër, nuk ju janë mbajtur sigurimet shtetërore suplementare në kundërshtim me ligjin nr. 8097, datë 21.03.1996 "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", i ndryshuar me ligjin nr. 9990 date 15.09.2008, neni 1 pika 9, si dhe referuar kërkesave të. Vendimit nr 499, date 21.09.2000 pika 3 dhe 4 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 26-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Pasi nuk është kryer inventarizimi i dosjeve të personelit sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 117, datë 05.03.2014, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” sipas lidhjes 1 dhe lidhjes 2, (*Trajtuar më hollësisht në faqet 26-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Pasqyrat e plotësuar për treguesit financiarë për vitin ushtrimor nuk janë shoqëruar me objektivat që ka institucioni për vitin 2015, të cilat do të jenë produktet dhe aktivitetet që do të realizohen me fondet e kërkuara, veprim në kundërshtim me standardet e parashikuara ne udhëzimet e hartimit te buxhetit për vitin 2015 në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 7 datë 28.02.2014 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2015-2017” si dhe udhëzimin plotësues (*Trajtuar më hollësisht në faqet 26-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Mungon bilanci paraprak verifikues, për të audituar procedurat e rakordimit, në zbatim të UMF nr. 14 datë 28/12/2006, pika 3.
- Ditarët e veprimeve kontabël nuk mbaheshin konform VKM nr. 783, datë 22/11/2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”, e konkretisht Kapitulli I “Mbajtja e kontabilitetit”;
- Si pasoje e mos regjistrimit të ditarëve të magazinave dhe mbajtëses së kontabilitetit nuk janë pasqyruar në bilancin e vitit 2015, vlera prej 433,645 lekë, materiale të nxjerra jashtë përdorimi, veprime këto në kundërshtim me ligjin Nr, 9228 datë 28.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

**C-2 Mbështetur në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “b”, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe në ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”, nenin 44 “Përgjegjësia e punonjësit të organit administrativ”, i rekomandoj Kryeinspektorit të Inspektoratit Qendror të Mjedisit dhe Pyjeve Tiranë, fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore, si më poshtë:**

**“Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj”, për 2 punonjës si më poshtë:**

**1. Për z. E. T. , me detyrë Kryeinspektor i ISHMP-së;**

- Pasi për dënimet administrative/ gjoba, të pa ankimuara nga subjektet brenda afateve që parashikon ligji i posaçëm, nuk ka respektuar afatet që pas kalimit të afatit 30 ditor të bëhej kërkesa drejtuar gjykatës për nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit dhe më pas ndjekjen nga shërbimi përmbarimor, veprime këto në papajtueshmëri me pikën 1 neni 22, pika 4 shkronja b e nenit 30 të Ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative” (Trajtuar më hollësisht në faqet 26-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2. Për z. A. Ll. , me detyrë specialist jurist;**

- Pasi për dënimet administrative/ gjoba, të pa ankimuara nga subjektet brenda afateve që parashikon ligji i posaçëm, nuk ka respektuar afatet që pas kalimit të afatit 30 ditor të bëhej kërkesa drejtuar gjykatës për nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit dhe më pas ndjekjen nga shërbimi përmbarimor, veprime këto në papajtueshmëri me pikën 1 neni 22, pika 4 shkronja b e nenit 30 të Ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative” (Trajtuar më hollësisht në faqet 26-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**C-3. Mbështetur në nenin 37 të “Kodit të Punës” dhe në zbatim të nenit 14 të Kontratës individuale të punës si dhe në ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”, nenin 44 “Përgjegjësia e punonjësit të organit administrativ”, i rekomandoj Kryeinspektorit të Inspektoratit Qendror të Mjedisit dhe Pyjeve Tiranë, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë dhe marrjen e masës disiplinore:**

**“Vërejtje me paralajmërim”, për 7 punonjës si më poshtë:**

**1. Për z. V. Z. , me detyrë inspektor i policisë pyjore në ISHMP Rajoni Shkodër, për shkeljet e trajtuara në procesverbalin nr. 6 dhe në faqet 13-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, të pasqyruara si më poshtë:**

Në **5 raste**, që i përkasin periudhës 1.01.2016 deri 30.06.2016 ka konstatuar prerje të paligjshme të pyjeve, duke kapur gjendje të pa transportuar lëndë drusore, të llojit lëndë përpunuese dhe

lëndë dru zjarri, por nuk ka hartuar dokumentacionin përkatës që vërteton marrjen e masave për bllokimin, sekuestrimin dhe dorëzimin e materialit në pikat e licencuara të grumbullimit, për rrjedhojë rezultoi e pa dorëzuar në pikat e grumbullimit sasia prej 100 m<sup>3</sup> lëndë përpunuese trup pishë dhe sasia prej 218.7 mst lëndë dru zjarri të llojit ah dhe lis, veprim ky në mospërputhje me nenin 39, të ligjit nr. 9385, datë 4.05.2005 “Për Shërbimin Pyjor” dhe me pikën 1, neni 11, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet administrative”.

- Në pesë raste që i përkasin periudhës 01.01.2015 deri 31.12.2015, nuk është bërë bllokimi dhe dërgimi për në pikën e ruajtjes sasia e sekuestruar prej 245 m<sup>3</sup> lëndë drusore. Veprime këto në papajtueshmëri me nenin 39 të ligjit nr. 9385 datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” neni 11, pika 1 të Ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 26-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Pasi në një rast nga ana e inspektorëve të ISHMP Shkodër, nuk është bërë bllokimi dhe dërgimi për në pikën e ruajtjes Beltoje mjet i tipit Benz, së bashku me sasinë prej 16 m<sup>3</sup> dru zjarri, duke cituar se lënda drusore çohet në pikë të bllokimit për llogari të DSHP Shkodër, por për të cilën nuk ka procesverbal dorëzimi ku të bëhet dorëzimi i lëndës dhe nënshkruhet nga marrësi në dorëzim, veprime këto në papajtueshmëri me nenin 39 të ligjit nr. 9385 datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” neni 11, pika 1 të Ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 26-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Pasi në një rast nga ana e inspektorëve të ISHMP Shkodër, nuk është bërë bllokimi dhe dërgimi për në pikën e ruajtjes Beltoje mjetin tip Ifa dhe lëndë drusore e llojit ah dru zjarri 6 m<sup>3</sup>, duke cituar se lënda drusore ju la me procesverbal bllokimi për llogari të DSHP Shkodër marrës në dorëzim R. R. , por për të cilën nuk ka procesverbal dorëzimi ku të bëhet dorëzimi i lëndës dhe nënshkruhet nga marrësi në dorëzim, veprime këto në papajtueshmëri me nenin 39 të ligjit nr. 9385 datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar dhe neni 11, pika 1 të ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 26-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2. Për z. A. B.** , me detyrë përgjegjës i sektorit të inspektimit pyjor Pukë të ISHMP-së Rajoni Shkodër, për shkeljet trajtuar në procesverbalin nr. 6 dhe në faqet 13-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, *të pasqyruara si më poshtë:*

Në **5 raste**, që i përkasin periudhës 1.01.2016 deri 30.06.2016 ka konstatuar prerje të paligjshme të pyjeve, duke kapur gjendje të pa transportuar lëndë drusore, të llojit lëndë përpunuese dhe lëndë dru zjarri, por nuk ka hartuar dokumentacionin përkatës që vërteton marrjen e masave për bllokimin, sekuestrimin dhe dorëzimin e materialit në pikat e licencuara të grumbullimit, për rrjedhojë rezultoi e pa dorëzuar në pikat e grumbullimit sasia prej 28.4 m<sup>3</sup> lëndë përpunuese trup pishë dhe sasia prej 5.3 mst lëndë dru zjarri të llojit ah dhe lis, veprim ky në mospërputhje me nenin 39, të ligjit nr. 9385, datë 4.05.2005 “Për Shërbimin Pyjor” dhe me pikën 1, neni 11, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet administrative”.

**3. Për z. D. E.** , me detyrë inspektor i policisë pyjore në ISHMP Rajoni Shkodër, për shkeljet trajtuar në procesverbalin nr. 6 dhe në faqet 13-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, *të pasqyruara si më poshtë:*

Në **5 raste**, që i përkasin periudhës 1.01.2016 deri 30.06.2016 ka konstatuar prerje të paligjshme të pyjeve, duke kapur gjendje të pa transportuar lëndë drusore, të llojit lëndë përpunuese dhe lëndë dru zjarri, por nuk ka hartuar dokumentacionin përkatës, që vërteton marrjen e masave për bllokimin, sekuestrimin dhe dorëzimin e materialit në pikat e licencuara të grumbullimit, për rrjedhojë rezultoi e pa dorëzuar në pikat e grumbullimit sasia prej 108 m<sup>3</sup> lëndë përpunuese trup pishë dhe sasia prej 210 mst lëndë dru zjarri të llojit ah dhe lis, veprim ky në mospërputhje me

nenin 39, të ligjit nr. 9385, datë 4.05.2005 “Për Shërbimin Pyjor” dhe me pikën 1, neni 11, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet administrative”.

- Pasi në pesë raste, që i përkasin periudhës 01.01.2015 deri 31.12.2015, nuk është bërë bllokimi dhe dërgimi për në pikën e ruajtjes sasia e sekuestruar prej 245 m<sup>3</sup> lëndë drusore, veprime këto në papajtueshmëri me nenin 39 të ligjit nr. 9385 datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” neni 11, pika 1 të Ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 26-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

-Pasi në 2 inspektime të kryera, për shkeljet e kushteve të lejes dhe për mos pajisje me leje mjedisi, që përbëjnë kundërvajtje administrative, nuk është aplikuar dënim administrativ me gjobë në shumën 600.000 lekë secili për lejet e mjedisit të tipit C në vlerë totale 19.500.000 lekë shumë e cila përbën e ardhur e munguar për buxhetin e shtetit, veprim në papajtueshmëri me shkronjat iii) iii) pika 1 neni 29 të Ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar, me pikën 1, neni 48 të Ligjit nr. 10 433, date 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

**4. Për z. Q. B. , me detyrë inspektor i policisë pyjore në ISHMP Rajoni Shkodër, për shkeljet trajtuar në procesverbalin nr. 6 dhe ne faqet 13-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, të pasqyruara si më poshtë:**

Në **6 raste**, që i përkasin periudhës 1.01.2016 deri 30.06.2016 ka konstatuar prerje të paligjshme të pyjeve, duke kapur gjendje të pa transportuar lëndë drusore, të llojit lëndë përpunuese dhe lëndë dru zjarri, por nuk ka hartuar dokumentacionin përkatës që vërteton marrjen e masave për bllokimin, sekuestrimin dhe dorëzimin e materialit në pikat e licencuara të grumbullimit, për rrjedhojë rezultoi e pa dorëzuar në pikat e grumbullimit sasia prej 28.4 m<sup>3</sup> lëndë përpunuese trup pishë dhe sasia prej 28.4 mst lëndë dru zjarri të llojit ah dhe lis, veprim ky në mospërputhje me nenin 39, të ligjit nr. 9385, datë 4.05.2005 “Për Shërbimin Pyjor” dhe me pikën 1, neni 11, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet administrative”.

**5. Për z. P. V. , me detyrë inspektor i policisë pyjore në ISHMP Rajoni Shkodër, për shkeljet trajtuar në procesverbalin nr. 6 dhe ne faqet 13-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, pasi:**

Në **4 raste**, që i përkasin periudhës 1.01.2016 deri 30.06.2016 ka konstatuar prerje të paligjshme të pyjeve, duke kapur gjendje të pa transportuar lëndë drusore, të llojit lëndë përpunuese dhe lëndë dru zjarri, por nuk ka hartuar dokumentacionin përkatës që vërteton marrjen e masave për bllokimin, sekuestrimin dhe dorëzimin e materialit në pikat e licencuara të grumbullimit, për rrjedhojë rezultoi e pa dorëzuar në pikat e grumbullimit sasia prej 28.4 m<sup>3</sup> lëndë përpunuese trup pishë dhe sasia prej 5.3 mst lëndë dru zjarri të llojit ah dhe lis, veprim ky në mospërputhje me nenin 39, të ligjit nr. 9385, datë 4.05.2005 “Për Shërbimin Pyjor” dhe me pikën 1, neni 11, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet administrative”.

**6. Për z. P. L. , me detyrë inspektor i policisë pyjore në ISHMP Rajoni Shkodër, për shkeljet trajtuar në procesverbalin nr. 6 dhe ne faqet 13-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit., si dhe të pasqyruara si më poshtë:**

Në **3 raste**, që i përkasin periudhës 1.01.2016 deri 30.06.2016 ka konstatuar prerje të paligjshme të pyjeve, duke kapur gjendje të pa transportuar lëndë drusore, të llojit lëndë përpunuese dhe lëndë dru zjarri, por nuk ka hartuar dokumentacionin përkatës që vërteton marrjen e masave për bllokimin, sekuestrimin dhe dorëzimin e materialit në pikat e licencuara të grumbullimit, për rrjedhojë rezultoi e pa dorëzuar në pikat e grumbullimit sasia prej 25.6 m<sup>3</sup> lëndë përpunuese trup pishë dhe sasia prej 5.3 mst lëndë dru zjarri të llojit ah dhe lis, veprim ky në mospërputhje me

nenin 39, të ligjit nr. 9385, datë 4.05.2005 “Për Shërbimin Pyjor” dhe me pikën 1, neni 11, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet administrative”.

**7. Për z. F. M.**, me detyrë inspektor i policisë pyjore në ISHMP Rajoni Shkodër, për shkeljet trajtuar në procesverbalin nr. 6 dhe ne faqet 13-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, të pasqyruara si më poshtë:

Ka konstatuar prerje të paligjshme të pyjeve, duke kapur gjendje të pa transportuar lëndë drusore, të llojit lëndë përpunuese dhe lëndë dru zjarri, por nuk ka hartuar dokumentacionin përkatës që vërteton marrjen e masave për bllokimin, sekuestrimin dhe dorëzimin e materialit në pikat e licencuara të grumbullimit, për rrjedhje rezultojnë e pa dorëzuar në pikat e grumbullimit sasia prej 100 m<sup>3</sup> lëndë përpunuese trup pishë dhe sasia prej 180 mst lëndë dru zjarri të llojit ah dhe lis, veprim ky në mospërputhje me nenin 39, të ligjit nr. 9385, datë 4.05.2005 “Për Shërbimin Pyjor” dhe me pikën 1, neni 11, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet administrative”.

**8. Për z. E. E.**, me detyrë inspektor;

- Pasi në pesë raste, nuk është bërë bllokimi dhe dërgimi për në pikën e ruajtjes sasia e sekuestruar prej 267 m<sup>3</sup> lëndë drusore, veprime këto në papajtueshmëri me nenin 39 të ligjit nr. 9385 datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” neni 11, pika 1 të Ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 26-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Pasi në një rast nga ana e inspektorëve të ISHMP Shkodër, nuk është bërë bllokimi dhe dërgimi për në pikën e ruajtjes Beltoje mjet i tipit Benz, së bashku me sasinë prej 16 m<sup>3</sup> dru zjarri, duke cituar se lënda drusore çohet në pik të bllokimit për llogari të DSHP Shkodër, por për të cilën nuk ka procesverbal dorëzimi ku të bëhet dorëzimi i lëndës dhe nënshkruhet nga marrësi në dorëzim. Veprime këto në papajtueshmëri me nenin 39 të ligjit nr. 9385 datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” neni 11, pika 1 të Ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 26-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- **Pasi** në një rast nga ana e inspektorëve të ISHMP Shkodër, nuk është bërë bllokimi dhe dërgimi për në pikën e ruajtjes Beltoje mjetin tip Ifa dhe lëndë drusore e llojit ah dru zjarri 6 m<sup>3</sup>, duke cituar se lënda drusore ju la me procesverbal bllokimi për llogari të DSHP Shkodër marrës në dorëzim R. R., por për të cilën nuk ka procesverbal dorëzimi ku të bëhet dorëzimi i lëndës dhe nënshkruhet nga marrësi në dorëzim, veprime këto në papajtueshmëri me nenin 39 të ligjit nr. 9385 datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar dhe neni 11, pika 1 të ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 26-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

#### **D. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR DHE QË NUK KANË ADRESIM INSTITUCIONAL.**

**1. Për z. F. Sh.**, me detyrë ish inspektor në Sektorin e Mjedisit, në ISHMP Rajoni Shkodër nuk është propozuar masë disiplinore, pasi masa ndaj tij konsiderohet e ezauruar. Masa e propozuar do të ishte “*Vërejtje*” deri në “*Largim nga shërbimi civil*”, pasi nga auditimi konstatohet se në 68 raste, që i përkasin periudhës 01.01.2015 deri 31.12.2015, për shkeljet trajtuar në procesverbalin nr. 7, nr. 3 dhe ne faqet 28-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, të pasqyruara si më poshtë:

- Gjatë ushtrimit të detyrave, janë konstatuar shkelje administrative, nga subjekte që nuk janë pajisur me leje mjedisore ose që kanë shkëlur kushtet e lejes, për të cilat janë lënë afate për të korrigjuar parregullsitë e konstatuara, por pas përfundimit të afateve, nuk kanë aplikuar dënim

administrativ me gjobë, si dhe nuk kanë aplikuar dënim administrativ për mos zbatim në kohë të masave korigjuese, në shumën 10,000 lekë secili dhe në vlerë totale 20,590 mijë lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për Buxhetin e Shtetit, veprime këto në papajtueshmëri me shkronjat iii) iii) pika 1 neni 29, të Ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar dhe pikën 5, pikën 6, neni 48, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Administrimit të Aseteve, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**